

PROJEKTIMI I SË ARDHMES

Si mund ta përmirësojë teknologjia pjesëmarrjen?

Përdorimi i teknologjisë për të mësuarin në shtëpi gjatë pandemisë së fundit u ka dhënë të rinjve përvojën për të qenë më të përgjegjshëm për të nxënëit vetjak. Shumë prej tyre do të dëshirojnë ta vazhdojnë këtë përvojë kur të kthehen në shkollë, pasi pandemia të ketë mbaruar. Ky mësim trajton mënyrat përmes të cilave të rinjtë mund të luajnë një rol më aktiv në edukimin e tyre kur të kthehen në shkollë, si dhe trajton mënyrat se si mund të ndihmojë teknologjia në këtë drejtim.

Nxënësi do të jetë në gjendje:

- ▶ Të reflektojë mbi përvojat e studimit në shtëpi dhe mbi përgjegjësitë e reja që kanë fituar (që pandemia u ka "veshur" atyre);
- ▶ Të analizojë mundësitë gjithnjë e në rritje të përfshirjes së tyre në vendimet që ndikojnë tek ata në shkollë;
- ▶ Të identifikojë mënyrat se si teknologjia mund t'i ndihmojë të bëhen pjesëmarrës më aktivë në arsimimin e tyre;
- ▶ Të zhvillojë të kuptuarit e demokracisë dhe aftësitë e të mësuarit në mënyrë të pavarur.

STIMULIM

Ushtrim reflektues:

Nxënësit reflektojnë mbi mënyrën se si e kalojnë orarin e tyre të mësimit gjatë kësaj periudhe që gjenden të izoluar në shtëpi. Ata krahasojnë një ditë mesatare mësimi në shtëpi me një ditë të tillë në shkollë përpara pandemisë. Nxënësit mendojnë për gjërat që kryejnë dhe për personat që vendosin për mënyrën dhe kohën se kur duhet të studiojnë ata. Ata i shkruajnë mendimet e tyre në formën e një table ose kllasteri (*harta e mendjes*) dhe i ndajnë ato me shokët e tjerë të klasës.

Për këtë, edhe pse nuk është e domosdoshme, do të ishte ideale puna në grupe dyshe, p.sh.: bisedat në *WhatsApp*.

Ekzistojnë mjete të ndryshme online falas, që mund të ndihmojnë për këtë, p.sh. *Coggle* për kllasterat.

DISKUTIM

Pas ushtrimit reflektues:

- ▶ Cilat mendoni se janë ndryshimet kryesore mes një dite mësimi në shtëpi dhe një dite mësimi në shkollë?
- ▶ Kush i merr vendimet në lidhje me çfarë mësoni dhe si mësoni ju në shtëpi? Kush i merr këto vendime në shkollë?
- ▶ Çfarë mendoni rreth kryerjes së detyrave të shkollës në shtëpi? Kush i merr vendimet për këtë?
- ▶ Kur të ktheheni në shkollë, a do të dëshironit të merrni më shumë vendime për veten tuaj? Po/Jo, Pse?
- ▶ Si mendoni, cilat janë disa nga vendimmarrjet për të cilat të rinjtë mund të luajnë rol më të madh në shkollë? Për çfarë gjërash nxënësit mund të vendosin vetë?
- ▶ Si mund ta përdorin shkollat teknologjinë, që të rinjtë të përfshihen më shumë në marrjen e vendimeve në shkollë?

Puna në grupe dyshe ose në grupe të vogla parapëlqehet për këtë seksion, por jo domosdoshmërisht. Mund të provoni të përdorni mjete për diskutim online, si *Padlet*.

Mund t'ju duhet të nxitni e të jepni shembuj, si p.sh.: votimi online për këshillin e nxënësve, një buletin informativ elektronik për nxënësit, një sondazh digital në shkollë për bulizmin.

PËRFUNDIM

Prezantimi i konceptit të të drejtave të fëmijëve, veçanërisht i së drejtës së fëmijëve për të shprehur pikëpamjet e tyre mbi çështje që ndikojnë mbi ta dhe për respektimin e këtyre pikëpamjeve. Ndonjëherë, kjo nënkupton aftësinë për të vendosur vetë për gjërat e tyre dhe, herë të tjera, ndarja e këtyre vendimeve me njerëzit e tjerë. Kjo, sigurisht, është në varësi të personave që përfshihen. Pa dyshim, që nuk është një e drejtë që u siguron atyre të marrin gjithçka që duan.

Lidhni këtë të drejtë me idenë e demokracisë. Shpjegoni se si e drejta për të luajtur një rol në vendimmarrje është thelbësore për demokracinë, por ajo duhet të ndahet me njerëz të tjerë.

Neni 12, Konventa për të Drejtat e Fëmijës.

DETYRË

Nxënësit mendojnë për mënyrën se si mund të përdoret teknologjia, që t'i ndihmojë të rinjtë të luajnë më shumë rol në vendimmarrje, pas mbarimit të pandemisë. Ata bëjnë një prezantim pamor, duke shpjeguar idenë e tyre dhe arsyet për të cilat ajo është një ide e mirë.

Puna në grupe të vogla do të ishte ideale, por jo e domosdoshme.

Për platforma online falas, shihni: <https://www.codemom.ai/best-online-presentation-tools-for-students/>

REZULTATET

Nxënësit bëjnë prezantimet e tyre në klasë. Klasa mendon rreth avantazheve dhe disavantazheve të propozimeve të ndryshme dhe vendosin se cili është më i miri.

Ata marrin parasysh nëse mund ta bëjnë këtë prezantim realisht pasi të kthehen në shkollë, për shembull, në bordin e shkollës.

Kujtojuini nxënësve të drejtat e fëmijëve për të zhvilluar plotësisht potencialin e tyre në lidhje me personalitetin, dhuntitë dhe aftësitë mendore e fizike (Konventa për të Drejtat e Fëmijës, neni 29).

Ky publikim është përkthyer dhe botuar në gjuhën shqipe në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës “Forcimi i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri”, i financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

Mendimet e shprehura në këtë publikim janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

